



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D / DPK
Dep.	01-1558/14
Nr. I faq.	
Broj stranica	02
Nr. pages	
Data	05.05.2014
Datum	
Date	
PRISHTINË	



**Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 29.04.2014, nxjerr këtë:

V E N D I M

I, Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-248-14 për znj. Merita Surkishi – Këshilltare në Asamblenë komunale në Prishtinë, për shkak se; nuk ka konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Por, zyrtarja Surkishi mund të gjendet në situatë të konfliktit të interesit “rast për rast”. Në raste të tillë, sipas ligjit, znj. Surkishi obligohet ta deklaroj ate dhe të tjeriqet nga vendimarrja.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-248-14, për Zyrtaren e lartë, znj. Merita Surkishi–Këshilltare në Asamblenë komunale në Prishtinë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligi Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-248/14, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, pas procedurës së shqyrimit, kemi konstatuar se nuk ka pasur prova të mjaftueshme që argumentojnë gjendjen e konfliktit të interesit.

Zyrtarja e lartë, znj. Merita Surkishi (Këshilltare në Asamblenë komunale të Prishtinës) duke ushtruar edhe pozitën Zavendës menaxhere e shërbimit me klientë&portoarkave, nuk ka rol vendimarrës në ndërrmarrjen publike Kompania Rajonale e Mbeturinave “Pastrimi” në Prishtinë. Sipas pëershkrimit të detyrave të punës të paraqitura në Kontratën e punës (Shkresa zyrtare DPK/Dpki-03-1374/14), ajo për punën e vet, i raporton Menaxherit të shërbimit me klient&zyrtarit kryesor financiar.

Ushtrimi i këtyre funksioneve mund të sjell eventualisht ndonjë situatë të konfliktit të interesit “rast për rast”, por, në bazë të Ligjit për Parandalimin e konfliktit të interesit Neni 13 paragrafi 1,

në këto situata zyrtarja është i obliguar që të bëjë deklarimin paraprak, rast për rast të interesave të saj private.

Kjo është e rregulluar me Nenin 13, paragrafi 1 në të cilin shprehimisht thuhet: "Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik, në bazë të njohurive të tij dhe me mirëbesim detyrohet që të bëje vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij privat lidhur me vendimmarjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit".

Deklarimi "rast për rast" i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtar i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikqyrës. Deklarimin si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa më shpejt që të jetë e mundur.(Neni 13, paragrafi 2).

Vet deklarimi si rregullë bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimmarje për ndonjë çështje të caktuar (Neni 13 paragrafi 3 i Ligjit Nr. 04/L-051).

Konflikti i interesit për anëtarët e Kuvendit komunal është i rregulluar edhe me Statutin e Komunës së Prishtinës, 01.nr.110-391, me 25.2.2010. Konkretnisht në nenin 40 paragrafi 2 dhe 3 shprehimisht thuhet:

40.2. Secili anëtar duhet t'i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit, që lindin në cilëndo nga mbledhjet, në të cilat është i pranishëm. Secili anëtar duhet të ofrojë informacione, që janë në interes të anëtarit tjetër.

40.3 Secili anëtar duhet të tërhiqet vullnetarisht nga procesi i marrjes së vendimeve dhe nga procedurat administrative, kur konsideron se ato mund të çojnë deri te konflikti i interesave.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

